



REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI

C.nr.112/08

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Valon Totaj, me procesmbajtësen Drita Qerreti, në kontestin e paditësit F. Q. nga Prizreni, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av. P. P nga Prizreni, kundër të paditurve A. Q. nga Prizreni, dhe E. Q. nga Prizreni, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë në bazë të shitblerjes, vlera e kontestit 50 euro, në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datën 06.10.2015, mori këtë:

A K T G J Y K I M
Në bazë të pohimit

I. APROVOHET në tërësi kërkespacia e paditësit F. Q. nga Prizreni dhe **vëretohet** se i njëjti në bazë të shitblerjes është pronar i paluajtshmërisë në sipërfaqe prej 39 m², të ngastrës kadastrale nr.5590/10 ZK Prizren, që është në sipërfaqe të tërësishme prej 300 m², në kuadër të pjesëve ideale të të paditurëve, përkatësisht 19.5 m² në kuadër të 1/3 të pjesës së të paditurit A. Q. dhe 19.5 m² në kuadër të 1/3 të pjesës së të paditurit E. Q., e cila sipërfaqe shtrihet në dimensione sikurse në vijim: në anën lindore në vijë të thyer në gjatësi prej 11.55 m, në anën perëndimore 9.77 m, në anën veriore 4.49 m dhe në anën jugore 2.57 m, përkatësisht sikurse në ekspertizën (plotësuese) të ekspertit të gjeodezisë K. G. të datës 24.08.2015, bashkë me skicën përcjellëse të cilat konsiderohen pjesë përbërëse e këtij aktgjykimi, andaj **detyrohen** të paditurit A. Q. dhe E. Q. që të dy nga Prizreni, që ta pranojë këtë fakt dhe që të lejojnë regjistrimin e kësaj pjese të paluajtshmërisë në emër të paditësit, pranë Drejtorisë së Gjeodezisë dhe të Kadastrës në Komunën e Prizrenit, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmabrimit me dhunë.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi F. Q. nga Prizreni, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av. P. P. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurve A. Q. nga Prizreni, dhe E. Q. nga Prizreni, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë në bazë të shitblerjes.

Në senacën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datën 06.10.2015, pas administrimit të të gjitha provave të propozuara, përkatësisht në fjalën përfundimtare të palëve, i padituri i parë A. Q. personalisht ka deklaruar se nuk e konteston kërkespacinë e

paditësit, përkatësisht se e pohon kërkespadinë e paditësit në sipërfaqe prej 19.5 m2 në kuadër të 1/3 të pjesës së tij të ngastrës kadastrale nr.5590/10 ZK Prizren, ngase sipas tij është e vërtetë se nga paraadhësit e tij, kjo pjesë e paluajtshmërisë, i është shitur këtu paditësit F. Q. nga Prizreni. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Edhe i padituri i dytë E. Q. nga Prizreni në senacën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datën 06.10.2015, pas administrimit të të gjitha provave të propozuara, përkatësisht në fjalën përfundimtare të tij ka deklaruar se nuk e konteston kërkespadinë e paditësit, përkatësisht se të njëjtën e pohon në tërësi si të bazuar për pjesën prej 19.5 m2 në kuadër të 1/3 të pjesës së tij të ngastrës kadastrale nr.5590/10 ZK Prizren, ngase është e vërtetë se stërgjyshi i tij, ia ka shitur këtë pjesë të paluajtshmërisë këtu paditësit. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 148 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjykata e mori duke u bazuar në nenin 452 të LPK-së, e kjo për faktin se asnjëra prej palëve nuk i ka kërkuar ato.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.112/08, datë 06.10.2015

Procesmbajtesja,
Drita Qerreti

Gjyqtari,
Valon Totaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve pas ditës së marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate. Bazuar në nenin 181.2 të LPK-së, ky aktgjykim mund të goditet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, apo nga shkakut se deklarata e pohimit është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin eventual të dhunës apo mashtrimit.